

**MBI NDËRHJRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2019**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2019

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹.) **Burimi:** Banka e Shqipërisë.

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1 javë<3muaj	REPO Njëditore
3-Tetor-19		13.65		
10- Tetor -19		20.01		
17- Tetor -19		22.45		
18- Tetor -19			2.11	
24- Tetor -19		18.09	2.47	
31- Tetor -19		16.42		
7-Nëntor-19		14.00		
13- Nëntor -19			1.77	
14- Nëntor -19		17.54		
21- Nëntor -19		15.75		
25-Nëntor-19			4.61	
2-Dhjetor-19		13.59		
5- Dhjetor -19		15.37		
12-Dhjetor-19		11.03		
19-Dhjetor-19		18.45		
24-Dhjetor-19			2.85	
26-Dhjetor-19		18.87		

Në tremujorin e katërt të vitit 2019, ndërhyrjet e BSh-së në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë, ka qenë 31.26 miliardë lekë kundrejt përkatësisht 33.61 miliardë lekëve, 26.88 miliardë lekë dhe 22.16 miliardë lekë në 3-mujorët e mëparshëm të vitit 2019. **Mesatarja e**

injektimeve të këtij viti, ka rezultuar 28.50 miliardë lekë kundrejt afër 39 miliardë lekëve në vitin 2018.

Mungesa e likuiditetit ka qenë e pandryshuar në fillim dhe në fund të periudhës në 32.68 miliardë lekë me volatilitet të ulët, të ndikuar kryesisht nga faktorët sezonalë mujorë.

¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti.

Ndërhyrjet në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, të kryera gjatë 3-mujorit, kanë ndikuar në rritjen graduale të likuiditetit në sistemin bankar me 6.8 miliardë lekë, ndërsa paraja në qarkullim është rritur me 6.08 miliardë lekë dhe e përqendruar në pjesën e dytë të periudhës.

Portofoli i BSH-së së bonove të thesarit ka rënë me 1.6 miliardë lekë, duke ndikuar në rritjen e likuiditetit të përhershëm të sistemit bankar. MFE-ja ka blerë nga Banka e Shqipërisë 66 milionë lekë, duke ulur likuiditetin në llogarinë e saj në lekë me afër 8.20 miliardë lekë dhe duke ndikuar në likuiditetin e sistemit bankar.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 16.70 miliardë lekë ose rreth 53.4% të injektiveve totale kundrejt përkatësisht 66% dhe 76% në 3-mujorët e mëparshëm. Pesha e injektiveve 1-javore është luhatur gjatë vitit 2019 në 17.7 miliardë lekë, ndërsa pesha e injektiveve të gjata në 10.80 miliardë lekë me një raport mesatar 61 dhe 39%.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2019 (me vlerë nominale).

Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese nga sistemi bankar.

Sistemi bankar ka përdorur depozitën në BSH për mesatarisht 6.20 miliardë lekë kundrejt mesatarisht 6.49 miliardë lekëve në 3-mujorin e mëparshëm dhe 7.10 miliardë lekëve në pjesën e parë të vitit.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 3 raste për shuma 0.4-1.25 miliardë lekë.

1.3 Operacionet për menaxhimin e portofolit të Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit të katërt të vitit 2019, portofoli i Bankës së Shqipërisë ka rënë me 1.6 miliardë lekë në 55.5 miliardë lekë. Banka e Shqipërisë ka ulur pjesëmarrjen në tregun primar në 5 ankande për në total 1.67 miliardë lekë, ndërkohë që ankandet e blerjes së bonove të thesarit në tregun sekondar të titujve, ku synohej rritja e portofolit me një shumë të ngjashme nuk janë plotësuar.

Siç shihet në grafikun e mëposhtëm, ndikimi i veprimeve me portofolin në likuiditetin e përhershëm të sistemit bankar në 5 vitet e fundit ka qenë minimal. ²

² Në grafik, vlera e portofolit për vitin 2019 pasqyron portofolin e BSH-së deri më 30 dhjetor 2019.

1.3 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë periudhës nuk janë kryer operacione të tërheqjes dhe injektimit njëditor të likuiditetit.

2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2019

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në përputhje me vendimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare të datës 18.12.2018 për të blerë valutë nga bankat e nivelit të dytë në vitin 2019, **me objektiv rritjen e rezervës valutore**, Banka e Shqipërisë gjatë periudhës ka organizuar 5 ankande të blerjes së valutës në përputhje me kalendarin e publikuar si më poshtë³:

Calendar of interventions - Year 2019		
	Date	Amount First Round (in Euro mln)
1	15/02/2019	3-6 mln
2	15/03/2019	3-6 mln
3	15/04/2019	3-6 mln
4	06/05/2019	3-6 mln
5	24/05/2019	3-6 mln
6	06/06/2019	3-6 mln
7	20/06/2019	3-5 mln
8	04/07/2019	3-5 mln
9	18/07/2019	3-5 mln
10	01/08/2019	3-5 mln
11	15/08/2019	3-5 mln
12	24/09/2019	3-4 mln
13	18/10/2019	3-4 mln
14	08/11/2019	3-4 mln
15	25/11/2019	3-4 mln
16	06/12/2019	3-4 mln
17	16/12/2019	3-4 mln

Në ankandet e organizuara nga Banka e Shqipërisë janë blerë 55.30 milionë euro kundrejt 42.10 milionë eurove të blera në 3-mujorin e mëparshëm dhe 57.20 milionë eurove të blera në 6-mujorin e parë të vitit. Totali i blerjeve për vitin 2019 rezultoi 154.60 milionë

³ Në fund të muajit dhjetor 2019, pas vendimit të KZKPM-së është publikuar në faqen zyrtare të internetit të BSH-së, kalendarin e ankandëve të vitit 2020.

euro. Në të gjitha rastet, Banka e Shqipërisë, ka përdorur opsionin e blerjeve në raund-in e dytë, sikurse parashikohet në rregullore.

Rezultatet e detajuara të të gjitha ankandëve të zhvilluara nga Banka e Shqipërisë mund t'i gjeni në lidhjen e mëposhtme:

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet_e_Bankes_se_Shqiperise/Nderhyrjet_ne_tregun_valutor/

2.3 Veprime me institucione të tjera

Gjatë 3-mujorit të katërt të vitit 2019, nuk ka pasur marrëveshje SWAP me MFE-në pas maturimit të marrëveshjes së fundit në muajin gusht për 3.73 miliardë lekë.

Në muajin tetor, Banka e Shqipërisë i ka shitur MFE-së 66 milionë euro.

Blerjet e zakonshme të valutës nga institucionet e huaja kanë qenë 198,198.20 USD, ndërkohë që janë blerë edhe 883,484.43 euro nga programi i Komunitetit Evropian IPA.